



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.34/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Hasan Shala, Ymer Hoxha, Zyhdi Haziri, Rafet Haxhaj, Nenad Laziq, Fejzullah Rexhepi, Afijete Sada-Gllogjani, dhe Adnan Konushevc, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Naim Pira, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Viti nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Viti, paraqitur kundër vendimit Nr. 1741/2017 të datës 19.09.2017 të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) për shkak të decertifikimit nga gara për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale 2017 si kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Viti, në seancën e panelit të mbajtur me 21.09.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i Naim Pira, për anulimin e vendimit Nr. 1741/2017 datë 19.09.2017 të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me të cilin parashtruesi i apelit është decertifikuar si kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Viti nga partia politike Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me datën 22.10.2017.

A r s y e t i m

Parashtruesi i apelit Naim Pira, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Viti nga subjekti politik LDK me datën 20.09.2017 ka paraqitur një apel në PZAP, kundër vendimit të KQZ-së me nr. protokolli 1741/2017 me të cilin pretendon se KQZ me datën 19.09.2017 e ka decertifikuar si kandidat nga lista e subjektit politik LDK për anëtar të Kuvendit Komunal në Viti. Parashtruesi i apelit kërkon nga PZAP-i që të anulohet vendimi i KQZ-së lidhur me decertifikimin e tij sepse i njëjti thekson se vendimi i KQZ-së bie ndesh dhe shkel dispozitat kushtetuese të nenit 45 paragrafi 1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, pasi që siç thekson ai i njëjti ka qenë i dënuar me dënim me kusht.

KQZ-ja, në përgjigjen në ankesë ka theksuar, se ka kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), që të bëjë verifikimin e kandidatëve që marrin pjesë në garë zgjedhore për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me 22 tetor 2017, nëse të njëjtit janë dënuar me

aktgjykim të plotfuqishëm nga Gjykatat e Republikës së Kosovës. Në këtë rast Naim Pira, kandidat për kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Viti nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), është i dënuar për vepër penale, në bazë të Aktgjykimit PKR.nr 340/2013 të datës 21.07.2017 të Gjykatës Themelore në Gjilan, i cili aktgjykim është bërë i plotfuqishëm me datën 21.07.2016. Andaj KQZ-ja, pretendon në përgjigjen në ankesë se ka vepruar konform nenit 29 par.4 Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), me rastin e marrjes së vendimit nr.1741/2017, që kandidati Naim Pira të de certifikohet si kandidat i listës së subjektit politik LDK, me propozim për panelin e PZAP-it, që apeli të refuzohet si i pabazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi të gjitha dëshmitë relevante, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, vlerësoi lejueshmërinë e apelit dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 122 të LZP-së dhe nenin 10 të Rregullës Nr. 02/2015-Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it.

Pretendimet ankimore të parashtresit të apelit se me rastin e marrjes së vendimit Nr. 1741/2017 datë 19.09.2017 nga KQZ-ja, lidhur me de certifikimin e tij nga gara e listës së kandidatëve për anëtarë të kuvendit komunal në Viti, ju është bërë e pa drejtë ngase ka qenë i dënuar me dënim me kusht, Paneli vlerëson se pretendimet e parashtresit të ankesës janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj dhe si të tilla u refuzuan, sepse neni 29 par.1 pika q) i LZP-së, për cakton se cili do person emri i të cilit paraqitet në Listën e Votuesve, është i aftë për certifikim, përveç nëse personi është shpallur fajtor për vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri (3) vitet e fundit, siç edhe është në rastin konkret ngase kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal në Viti Naim Pira me aktgjykimin PKR.nr 340/2013 të datës 21.07.2016 të Gjykatës Themelore në Gjilan, i cili është bërë i plotfuqishëm me datën 21.07.2016, është shpallur fajtor për vepër penale në tri vitet e fundit para certifikimit.

Mbi këtë bazë Paneli, konstaton se KQZ-ja, me rastin e marrjes së vendimit Nr. 1741/2017 datë 19.09.2017, drejt ka zbatuar dispozitën ligjore të nenit 29 par. 4 të LZP-së, pasi që kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Viti Naim Pira, nga radhët e subjektit politik LDK, pasi që është certifikuar nga KQZ-ja, si kandidatë, me të dhënat që kanë rezultuar nga KGJK-ja, e ka humbur aftësinë për te qenë kandidatë sipas dispozitës ligjore te nenit 29 par.1 pika q), të LZP-së, pasi i njëjti është shpallur fajtor për vepër penale me aktgjykim përfundimtar në tri (3) vitet e fundit, sipas aktgjykimit, PKR.nr 340/2013 të datës 21.07.2016 të Gjykatës Themelore në Gjilan, është bërë i plotfuqishëm me datën 21.07.2016. Mbi këtë bazë vendimi i KQZ-së, për decertifikimin e apeluesit dhe largimin e

tij nga lista e kandidatëve të subjektit politik është i ligjshëm dhe çdo pretendim në apel mbi këtë bazë është i pa qëndrueshëm.

Pretendimi i parashtruesit të ankesës se ai nuk është përgjegjës dhe se e ky dënim është përfunduar, nuk është bazë ligjore për të vendosur ndryshe sipas nenit 29 par.1 pika q), të LZP-së, pasi sipas kësaj dispozite përcaktohet *“Cilido person emri i të cilit paraqitet në listën e votuesve është i aftë për certifikim si kandidat përveç nëse kandidati është i shpallur fajtor për vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri (3) vitet e fundit”*, andaj përmbushja obligimeve që kanë rezultuar nga aktgjykimi i lartpërmendur nuk paraqesin referencë ligjore, për marrjen e vendimit më të favorshëm ndaj parashtruesit të apelit.

Paneli me rastin e vendosjes mori parasysh edhe dispozitën e nenit 45 par. 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në të cilin përcaktohet se : *“Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën 18 vjeç, qoftë edhe në ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor”*. Kjo e drejtë e garantuar me kushtetutë parashtruesit të apelit nuk ju është kufizuar me vendimin e ankimuar të KQZ-së, pasi që pikërisht me nenin 55 par. 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është përcaktuar se: *“Te drejtat dhe liritë themelore të garantuar me këtë Kushtetutë mund të kufizohen vetëm me ligj”*. Ndërsa, në rastin konkret kjo e drejtë parashtruesit të apelit për tu zgjedhur ju është kufizuar me nenin 29 par. 4, të LZP-së, pasi që parashtruesi i apelit e ka humbur aftësinë për te qenë kandidat sipas nenin 29 par. 1 pika q), të LZP-së.

Sipas vlerësimit të panelit edhe përmbajtja e dispozitës së nenit 45 të Kushtetutës, *“gëzon të drejtën të zgjedh dhe të zgjedhet me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor”* është komentuar, në komentarin e Gjykatës Kushtetuese¹, në këtë rast kemi të bëjmë me formën e dytë të mbrojtjes gjyqësore të kësaj të drejte, në kuptimin që Kushtetuta në këtë paragraf të nenin 45 paraqet prezumime për vendosjen e disa shkallëve dhe të formave të mbrojtjes së kësaj të drejte, e cila më vonë rregullohet me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë. Në vështrim të këtij Ligji, shkalla e parë dhe forma e mbrojtjes së kësaj të drejte është mbrojtja administrative brenda Komisionit Qendror Zgjedhor (neni 64 lidhur me nenin 98); e dyta është në PZAP si institucion i përhershëm dhe i pavaruar në përbërje prej gjyqtarëve (115;118-119), ndërsa e treta është mbrojtja e plotë gjyqësore në Gjykatën Supreme të Kosovës (neni 118.4)”. Nga kjo rezulton se mbrojtja e të drejtës gjyqësore e garantuar me Kushtetutë konsumohet me vendimin e PZAP-së dhe mundësinë që i njëjti të ankimohej në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës.

Paneli ka pasur parasysh praktiken e krijuar nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, me rastin e vendosjes në rastet e ngjashme për decertifikimin e kandidatëve për zgjedhjet lokale që do të mbahen më datë 22.10.2017, por ka vlerësuar se nuk është në mundësinë e PZAP-it, që të vlerësoi nëse neni 29 par.1 pika q), të LZP-së, është në kundërshtim me

¹Enver Hasani & Ivan Čukalović, Komentari i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, fq. 159-167, Dhjetor 2013.

nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, pasi bazuar në nenin 112, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është përcaktuar **“Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën”**, prandaj Paneli vlerëson se vlerësimi i një dispozite ligjore që është në kundërshtim me Kushtetutën, është në kompetencë të vlerësimit të kushtetutshmërisë, është tagër e Gjykatës Kushtetuese.

Po ashtu Paneli nuk ka mundur që të dërgoi kërkesën për interpretim të nenit 29 par.1 pika q), të LZP-së, në Gjykatën Kushtetuese të Republikë së Kosovës, pasi që me nenin 113 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, janë përcaktuar në mënyrë decisive se kush janë palët e autorizuara për të kërkuar interpretim të dispozitave ligjore, prandaj Paneli në mungesë të autorizimit, nuk ka mundur të inicion çështjen, por e ka zbatuar dispozitën ligjore të lartë theksuar ashtu siç është e përcaktuar, duke marr parasysh se ky ligj është ligj special për fushën e zgjedhjeve dhe dispozitat e tij kanë prioritet në raport me të gjitha dispozitat tjera ligjore, ndërsa kufizimi i sipas këtij neni, është lejuar me nenin 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1, 122 par.1 pika b) të LZP-së, si dhe nenit 11 par.6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL A nr. 34/2017 më datën 21.09.2017.

Kryesuesi i Panelit
Gyltene Sylejmani



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.